



Nr. 2360/7 prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Elbasan, me 02.11.2021

VENDIM

Nr. 44 datë 02.11.2021

Për
ambientet e UE-së dhëna me qira

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 137 date 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", VKM-së Nr.54, datë 05.02.2017 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; VBA nr. 8, datë 06.03.2021 "Për miratimin e plan buxhetit të vitit 2021", i ndryshuar, VBA nr. 4, datë 05. 01.2021 "Për dhënie me qira ambientet e UE-së" Bordi i Administrimit ,

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurës së marrjes në dorëzim të objektit të dhënë me qira në mjediset brenda godinës së Fakultetit Ekonomik me sipërfaqe ndërtese 68.3 m² dhe trualli i lirë funksional 57.2 m², duke përfshirë investimin e kryer nga qiramarrësi "Irma Bardhi PF" për mjedisin e tipit duplex me sipërfaqe funksionale në ndërtesë të shtuar me 40 m². Me këtë investim sipërfaqja funksionale në ndërtesë është 108.3 m².
2. Të shtohet në vlerën e objektit kosto ndërtimore e përlloritur me vlerë 1,293,240 lekë.
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DËRMISHI

